



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Adresa: Rruga "AbdiToptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site:www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më 2019

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____ 2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË "AGJENCINË KOMBËTARE TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË
MBETJES" TIRANË

"Mbi auditimin e përputhshmërisë për periudhën nga data 01.05.2016 deri më datën 31.07.2019"

Nga auditimi i ushtruar në "Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve" krahas anëve pozitive rezultoi se, ka dhe devijime materilae në zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e prokurimeve në fushën e Prokurimit Publik dhe të Kontrollit dhe Disiplinimit të Punimeve të Ndërtimit, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë" të ushtruar në "Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipas programit të auditimit nr. 362/1, datë 29.05.2019, i ndryshuar, për veprimtarinë nga data 01.05.2016 deri më datën 31.07.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Për drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

Nëaudituaam përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon investime nëinfrastrukturën e ujësjellës kanalizimeve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin “Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***²

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së meStandardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të mjaftueshme të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e AKUM,rezultoi se, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi të cilat kryesisht konsistojnë: në shkelje të ligjshmërisë në Prokurimit Publik dhe në shkelje të ligjshmërisë në Kontrollit dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit.

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² ISSAI 4000– Udhërrëfyese i Auditimit të Përputhshmërisë

³Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aqmaterialesatëjustifikojnëdhënien e *opinionit*tëkundërtosenjërefuzimtëopinionit

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Në raportet e monitorimit u konstatua se mungon relacioni shpjegues i treguesve të realizuar me planin, si dhe masat korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Veprime në kundërshtim me pikën 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

- Në raportet e monitorimit për 8- mujor mungojnë informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”

- Në raportet e monitorimit mungon evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”

- Në raportet e monitorimit mungon rakordimi me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për shpenzimet buxhetore të realizuara nga institucioni.

- Raportete Monitorimit për vitet objekt auditimi nuk janë të publikuar në faqen zyrtare të AKUM, pasi institucioni nuk disponon një faqe zyrtare në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

(Trajtuar më hollësisht nëfaqet 7-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1Rekomandim:Drejtorja e Monitorimit dhe Mbikëqytres në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Investimeve në AKUM të marrin masat që:

- Në raportet e monitorimit të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

- Në raportet e monitorimit të jenë të evidentuara dhe të trajtuara detyrimet e prapambetura, të cilat duhet të konsiderohen si prioritetet nga institucioni, me qëllim marrjen e masave për likuidimin e tyre në të ardhmen.

Në vijimësi

1.2. Rekomandim: Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, institucioni të krijojë faqen e tij në internet për të vënë në dispozicion të publikut, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

Afati për zbatimin e rekomandimit: *Në vazhdimësi*

2.Gjetje nga auditimi: Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, janë paguar nga buxheti i shtetit 75,272,985 lekë, të ndara në 68,992,800 lekë për proceset gjyqësore në lidhje me shpronësimet; 2,735,532 lekë për proceset e fituara nga punonjësit e larguar nga puna dhe 3,544,653 lekë për tarifatat e shërbimeve përmbartimore. Nga auditimi u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga AKUKM, por janë kryer në bazë të urdhër

ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke rënduar buxhetine shtetit me kosto shtesë për tarifën përmbarimore.

- Gjithashtu konstatohet se, nga institucioni ndër vite nuk ka një fond të planifikuar për proceset gjyqësore të cilat janë në shkallën e dytë të apelimit. Në PBA-në e institucionit nuk është planifikuar një fond për këto detyrime, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-23, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike për çdo proces gjyqësor, i cili ka kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, të informojë Sektorin e Financës, për të planifikuar një shumë që në fazat e PBA-së, me qëllim që ekzekutimi i tyre të bëhet vullnetarisht, për të eliminuar shpenzimet përmbarimore në dëm të buxhetit.

- Nga institucioni duhet të krijohen provizionet për shpenzime gjyqësore pasi janë ngjarje të ndodhura dhe kanë probabilitet që do të sjellin detyrim për t’u paguar. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në fund të procesit të inventarizimit u konstatua se komisioni nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku të jepte komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (nëse janë apo jo në përdorim), si dhe për kushtet e ruajtjes së tyre dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nga auditimi u konstatua se, nuk ishte vendosur numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbalit të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, veprim në kundërshtim me pikën 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

- Për vitet objekt auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit nuk ka nxjerrë një vlerë totale dhe listë të detajuar, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj., sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimin gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca, veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74, 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

Komisioni i ngritur me urdhër të titullarit të institucionit me nr. 23, datë 28.02.2019 “Për ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimi të aseteve të vlerësuara për jashtë përdorimi”, nuk ka marrë asnjë masë për të vazhduar procedurën e tjetërsimit, e cila duhet të ishte realizuar brenda datës 30.04.2019, sipas këtij urdhri.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-23 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Komisioni i inventarizimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të AKUM-së të marrë masa, që në raportin që i drejtohet titullarit në fund të procesit të inventarizimit, të bëjë një ndarje të aktiveve gjendje që disponon institucioni, sipas zërave duke bashkëngjitur listën e tyre në relacionin, me qëllim verifikimin e gjendjes së tyre, si dhe verifikimin e diferencave me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas zërave. Në

momentin që komisioni i ngritur nuk arrin të bëjë inventarizimin e zërave të caktuar të kërkojë nga titullari, për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për aktivet që nuk mund ti inventarizojnë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Rekomandimi: Komisioni i tjetërsimit/nxjerrjes jashtë përdorimi të aseteve, të marrë masa që, për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi, pas vlerësimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, të hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, si dhe të behën hyrje në magazine, si dhe t'u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur ose djegur.

Afati për zbatimin e rekomandimit: *Në vazhdimësi*

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit, "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II (Linjat KUZ Përroi Agait, Stacioni Pompimit Nr.1 deri tek Stacioni Pompimit Nr.2) me fond limit 353,062,840 lekë pa TVSH, dhe "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe KUZ në fshatin Luz, Kavaje" me fond limit 307,415,618 lekë pa TVSH, u konstatua se:

-Në këto procedura, një nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk është hartuar sipas kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Konkretisht, është kërkuar që operatorët të paraqesin për të vërtetuar përvojën e suksesshme të mëparshme vetëm kontrata për punë në Kanalizime të Ujërave të Zeza (KUZ) dhe jo në Ujësjellës-Kanalizime. Mirëpo kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht dhe plotësohet nga kërkesa tjetër të kërkuar po në DT, që operatorët duhet të jenë të pajisur edhe me disa licenca profesionale. Këto licenca kanë të bëjnë me aftësinë profesionale të operatoreve për zbatimin e punimeve të ndërtimit. Por në asnjë licencat e kërkuara dhe as në VKM nr.42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", nuk ka të përcaktuar që përpunime në Kanalizime të Ujërave të Zeza të lëshohen licenca profesionale. Këto lloj punime përfshihen në licencën NP 7 E, që ka të bëjë me: "Punime në Ujësjellësi, gazsjellësja, vepra kullimi e vaditje". Pra janë punime të përbashkëta me Ujësjellës-Kanalizime dhe operatorët ekonomik që kanë ekzekutuar me sukses kontrata të mëparshme për punë në ujësjellës e kanalizime, lehtësisht dhe natyrshëm të japin siguri që mundë të ekzekutojnë me sukses edhe kontrata që kanë të bëjnë vetëm me punime në KUZ.

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt, "Impianti i Trajtitimit të Ujërave të Ndotura në zonën Bregdetare Dhrale -Palase, Loti I parë" me fond limit 129,512,139 pa TVSH, me fitues operatorin ekonomik "G....." me vlerë oferte 115.254,993 lekë, u konstatua se:

Në këtë procedurë, një nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk është hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, është kërkuar që operatorët të paraqesin për të vërtetuar përvojën e suksesshme të mëparshme vetëm kontrata për punë në Impiant të Trajtitimit të Ujërave të Ndotura (ITUN dhe jo në Ujësjellës-Kanalizime. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht dhe plotësohet nga kërkesa tjetër të kërkuar po në DT, që operatorët duhet të jenë të pajisur edhe me disa licenca profesionale. Këto licenca kanë të bëjnë me aftësinë profesionale të operatoreve për zbatimin e punimeve të ndërtimit. Por në asnjë nga licencat e kërkuara dhe as në VKM nr.42 datë 16.01.2008, nuk ka të përcaktuar që përpunime në ITUN, të lëshohen licenca profesionale Këto lloj punime përfshihen në licencën NP 7 E, që ka të bëjë me: "Punime në ujësjellës, gazsjellësja, vepra kullimi e

vaditje". Pra janë punime të përbashkëta me Ujësjellës-Kanalizime dhe operatorët ekonomik që kanë ekzekutuar me sukses kontrata të mëparshme për punë në ujësjellës e kanalizime, lehtësisht dhe natyrshëm të japin siguri që mund të ekzekutojnë me sukses edhe kontrata që kanë të bëjnë vetëm me punime në punë në Impiant të Trajtimit të Ujërave të Ndotura.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 27-32 dhe 46-50, të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi (4 dhe 5): Në procedurat e prokurimit që AKUKM do të realizojë në vijim, kriteret e veçanta kualifikuese, veçanërisht ato që lidhenpërvojën e suksesshme në kontrata mëparshme, të hartohen nëraport mepunimet që do të kryhen, sipas kontratës që prokurohetdhe në përputhje me kategoritë e punimeve sipaslicencave profesionale të përcaktuara nëVKM nr.42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "Ujësjellësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Galldishtë& Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit Ersekë" me fond limit 363,748,731 lekë u konstatua se:

Një nga kriteret e veçanta kualifikuese nuk është hartuar sipas kërkesave të nenin 20, piken 3 të nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", dhe me nenin 26 "kontratat e punëve " të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Konkretisht, është kërkuar që operatorët për të vërtetuar përvojën e suksesshme të mëparshme, nëse kontrata është realizuar si Nënkontraktor duhet të paraqesin, kontrata baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor. Kjo kërkesë është diskriminuese. Paraqitja nga Nënkontraktori, të kontratës bazë e cila lidhet ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, nuk është detyrim ligjor që Kantraktori duhet t'ia vejë në dispozicion Nënkontraktorit, sepse nuk ka lidhje më Nënkontraktorin. Kontrata bazë është një marrëdhënie juridiko-ekonomike ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor dhe kjo e fundit ka detyrimin ligjor të miratojë zyrtarisht Nënkontraktorin dhe paraqitja e dokumentit të miratimit nga nenKontraktori, dëshmon dhe vërteton më së miri ligjshmërinë dhe realizimin e punimeve nga Nënkontraktori. Pra Kontrata e lidhur ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor mund të konsiderohet konfidenciale dhe Nënkontraktori mund ta këtë të pa mundur t'ia marrë Kontraktorit dhe për ta paraqitur në tender.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-58 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi:Autoriteti Kontraktor AKUKM, të marrë masa që në të ardhmen, në procedurat e prokurimit që do të realizojë, për përmbushjen e kriterëve të veçanta kualifikuese nga operatorët ekonomik, ne rastet e kërkesë kur kontrata është realizuar si Nënkontraktor,të mos kërkohet ne DT që, operatorët të paraqesin kontratën baze të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit.

Afati për zbatimin e rekomandimit: *Në vazhdimësi*

B.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në dosjen teknike, të kontratës për zbatimin e punimeve të objektit " Impianti i Trajtimit të Ujërave të ndotura në zonën Bregdetare Dhrale-Palasë, Loti I ", me vlerë 138,305,992,26 lekë me TVSH, në situacionit pjesor nr. 5, dhe në librezën e masave konstatohen disa pasaktësi. Konkretisht në kapitullin e ITUN (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura), Loti Nr. 1, Zëri nr. 1, me nr. analize 2.48/an "Gërmim shkëmbi i fortë me çekiç

me ekskavator me zinxhir" dhe nr. 8, me numër analize 3.158/5a "Transport dherash deri në 5km".

Sipas projekt-preventivit të tenderuar, është parashikuar që sasia e gërmimit të shkëmbit të fortë të transportohet me zërin e transportit të dherave. Pra sasia totale e gërmimit duhet të jetë e njëjtë me sasinë e transportit të dherave. Zëri nr. 1, me nr. analize 2.48 /an "*Gërmim shkëmbi i fortë me çekiç me ekskavator me zinxhir*", në situacionin e 5 janë likuiduar 2,742 m³, ku një pjesë e kësaj sasive është përdorur në zërin "*Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm, tok zakonshme*", në sasinë 666 m³. Pra sasia e cila duhet të transportohet është $(2,742 \text{ m}^3 - 666 \text{ m}^3) = 2,076 \text{ m}^3$. Ndërkohë, zëri i transportit të dherave në situacionin nr. 5, është likuiduar në sasinë prej 1,500 m³, pra me një diferencë prej **576 m³**. Rrjedhimisht, konstatohet pasaktësi, duke u mos përputhur volumi i gërmimit të shkëmbit të fortë me çekiç, i cili duhej të ishte $1,500 \text{ m}^3 + 666 \text{ m}^3 = 2,166 \text{ m}^3$. Pra konstatohet se në situacionin nr. 5, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, më shumë volume të gërmimit në shkëmb të fortë, në sasinë prej 576 m³, me çmimin përkatës prej 3,200 lekë/m³, rezulton vlera prej 1,843,200 lekë pa TVSH ose **2,211,840 lekë me TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik, deri në rakordimin përfundimtar të pagesës së fundit

(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-85 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: AKUKM në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrin masa, që në situacionin e ardhshëm të rakordojë dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative për riparimin e dëmit në **shumën 2,211,840 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga ana e AKUKM është nënshkruar kontrata nr.2482, date 31.08.2017 me objekt "Furnizim makineri-pajisje për Ndërmarrjen SHA Vlorë" dhe subjektit "V..." me vlerë 151.543,951 lekë pa TVSH dhe afat zbatimi 12 muaj nga lidhja e kësaj kontrate. Sipas faturave të Kontraktorit furnizimi me këto mallra ka filluar me datë 04.10.2017.

Me datën 24.07.2018 subjekti "V...", pra pothuajse 1 muaj para përfundimit të kontratës i kërkon AKUKM ndryshimin e specifikimeve teknike për gjeneratorin e lëvizshëm, pas dy shkresave tjera që datojnë nga 23.05.2018, për të cilat AKUKM nuk është përgjigjur. Sipas kësaj kërkesë propozohet një kullë e re ndriçimi e cila, sipas Kontraktorit ka disa avantazhe dhe duhen dy muaj për ta prodhuar dhe se fabrika në Itali, ka pushim muajin gusht.

Me datë 26.07.2018, me një shkresë të përgatitur nga Përgjegjësi i sektorit të programimit të investimeve dhe master planit dhe të miratuar nga N/Drejtori i Përgjithshëm për Drejtorin e përgjithshëm, kanë propozuar shtyrjen e afatit me 60 ditë, duke përdorur referencë pikën 26.5 të kontratës. Një veprim i tillë nuk është i bazuar ligjërisht dhe referimi në këtë pikë është i deformuar, pasi zgjatja e afatit duhet të jetë në interesin publik për ta bërë këtë. Interesi publik nuk mund të lidhet me ndryshimet e specifikimeve teknike brenda afatit të zbatimit të kontratës për një element të një zëri të mallrave të prokuruar, pa kaluar as një vit nga nënshkrimi i saj, për më tepër që nuk është marrë në konsideratë ecuria e zbatimit të kësaj kontrate. Duhet theksuar se deri në datën e miratimit të kësaj kërkesë Kontraktori ka realizuar vetëm 26 % të në vlerës së kontratës.

Këto ndryshime janë miratuar me datë 30.07.2018 nga Drejtori i Përgjithshëm i AKUKM z. A.. S... Në këtë mënyrë është zbatuar pika 1 e nenit 27 "Kontratat e mallrave" e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, e cila përcakton: "*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*".

Pasi, specifikimet teknike të mallrave në DT të paraqitura nga AK janë pranuar nga Kontraktori “V...”. Pas kësaj Kontraktori “V...”, në shkresën pa datë dhe të pa protokolluar në AKUKM, ka kërkuar shtyrjen e afatit të kontratës me minimalisht dy muaj.

Me datë 30.08.2018 është nënshkruar midis palëve amendament kontrate me afat maksimal 31.10.2018, në të cilën AKUKM e përfaqësuar nga z. A...S... Një veprim i tillë është marrë në kundërshtim me:

- Pikën 26.4 dhe 26.5 të kontratës nr. nr.2482, date 31.08.2017 me objekt ”Furnizim makineri-pajisje për Ndërmarrjen SHA Vlorë”, pasi nuk është as në kushtet e forcës madhore dhe as të interesit publik për ndryshime të specifikimeve teknike të një elementi (kullë ndriçimi) të gjeneratorit;

- Është nënshkruar ditën e përfundimit të afatit të kontratës bazë, pa marrë në konsideratë ecurinë e zbatimit të saj, pasi Kontraktori deri në këtë datë ka sjellë vetëm 43 % e vlerës së kësaj kontrate.

Sipas dokumentacionit të pagesave të faturave të kësaj kontrate rezulton se janë mbajtur penalitete në vlerën 3,279,842 lekë, me përlllogaritje të vlerës 1/1000 për çdo ditë vonesë për kontrata me afat zbatimi mbi 12 muaj. Një veprim i tillë është bazuar në dokumentin e datës 05.06.2019 “Mbi ndalesë në pagesë të subjektit “V...” në përmbushje të rekomandimeve të Taskforcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, për kontratën nr. 2482, datë 31.08.2017, me objekt “Furnizim makineri-pajisje për Ndërmarrjen SHA Vlorë”. Në fakt vlera e mallrave të cilave ju referohet përlllogaritja janë ato që Kontraktori duhej t’i dorëzonte brenda afatit 12 mujor. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Pikën 27.1, shkronja “b” e kontratës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 85-87, të Raportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrë masa për zbritjen e penaltetit me vlerë 3,279,842 lekë Kontraktorit "V...", krahas penaltetit të mbajtur më parë me vlerë 3,279,842 lekë, si pasojë e mos zbatimit me korrektësi të llogaritjeve për vonesa në zbatimin e kontratës.

Afati për zbatimin e rekomandimit: *Menjëherë*

3. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, “Furnizim Makineri – Pajisje për Ndërmarrjen SH.A, Vlorë” me fond limit 154,636,278 lekë pa TVSH, me fitues operatorin “V...” me ofertë 151,543,951 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 3 operatore ekonomike. Një nga këta operatorët “P..I..” sipas KVO, është s`kualifikuar se nuk plotëson kriteret e veçanta të kërkuara në DT. Ky operator, ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 14,907,951 lekë, pa TVSH. Për këtë skualifikim ky operator ka bërë ankesë pranë AK i cili nuk e ka marrë parasysh këtë ankesë. Në vijim, operatori ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 496, date 06.07.2017 ka vendosur, të mos e pranojë ankesën e operatorit “POWER INDUSTRIES”. Me këtë vendim të KPP, ky operator, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila me vendim nr. 4980, datë 22.12.2017 ka rrëzuar ankesën e operatorit “P..I..”. Përsëri ky operator ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me Vendimin nr.22236, datë 31.05.2018 ka vendosur: ndryshimin e Vendim nr. 4980, datë 22.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë duke shfuqizuar vendimit e KPP nr.496, datë 05.07.2017 dhe detyrimin e AKUKM të shpërblejë këtë shoqërinë shumë 16,389,000 lekë. Me njohjen e këtij vendimi, KPP, AKUKM në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit kanë bërë rekurs kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë, Tiranë me shkresë nr.1178/1, datë 12.07.2018. Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë.

Meqenëse çështja e skualifikimit të këtij operatori vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat e Lartë, auditimi nuk mund të dalë me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të

këtij s`kuaifikimi. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipër me qëllim shmangien e tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankesave, si dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa efencë, efektivitet dhe ekonomicitet apo dhe dëmeve ekonomike që mund të rrjedhin nga fitimi i gjyqeve nga operatori dalim me konkluzionin se, KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtij operatori ti konsideronte si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën 18,113,941 lekë, me TVSH, i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-27 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: AKUKM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit në shumën 18,113,941 lekë.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

3.2. Në përfundim të procesit gjyqësor nga Gjykata e Latë,në rast sevendimi i Gjykatës është në favor të operatorit të skualifikuar,të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik që përcaktohet nga vendimi i gjykatës .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

4. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Përfundimi i rrjetit te Kanalizimeve te Ujërave te Zeza ne zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II (Linjat KUZ Përroi Agait, Stacioni Pompimit Nr.1 deri tek Stacioni Pompimit Nr.2) me fond limit 353.062.840 lekë pa TVSH, me fitues Operatorin ekonomik “A...K...” me ofertë 331,573,620 lekë. Në këtë procedurë nga 6 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 5 operatorë ekonomik. Një nga operatorët “G...”,sipas KVO,është s`kualifikuar me arsyen se, nuk plotëson kriteret e veçanta të kërkuara në DT dhe veçanërisht nuk plotëson e kriterit për punë të ngjashme. Ky operator ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 43,135,663 lekë, pa TVSH. Operatori Ekonomik “G...” ka bërë ankesë pranë AK i cila nuk e ka marrë parasysh këtë ankesë. Më pas ky operatorë ka paraqitur ankesë në KPP i cili në përfundim të shqyrtimit në themel, me Vendimin nr. 822/2016, datë 26.10.2016 ka vendosur, të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “G...”. Me këtë vendim të KPP, operatori “ G... “, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë ankesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë e cila me Vendimin nr.845, datë 06.03.2017 ka vendosur: shfuqizimin pjesërisht të Vendimit nr.822/2016 , datë 26.10.2016 të KPP, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Gener 2”.Menjëherë me njohjen e këtij vendimi, KPP, AK dhe Avokati i Shtetit kanë bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Apeli, Tiranë. Konkretisht çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi nga kjo Gjykatë.

Meqenëse çështja e skualifikimit të tij vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat administrative, auditimi nuk mund të dal me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre skualifikimeve. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipër me qëllim shmangien e tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe pa efencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, dalim në konkluzionin se, KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” për të vlerësuar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të operatorit “ G... “ devijime të vogla.Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën

51,762,795 lekëme TVSH i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s'kualifikuar.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-32 të Raportit të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: AKUKM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 51,762,795 lekë .
Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

4.1.Në përfundim të proceseve gjyqësore, në rast se,Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të skualifikuar,të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik që përcaktohet nga vendimi i gjykatës .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

5.Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt,"Ndertim i rrjetit te ujësjellësit dhe KUZ ne fshatin Luz, Kavaje" me fond limit 307,415,618 lekë pa TVSH, me fitues Operatori Ekonomik 'A..K...' me vlerë oferte 294,815,756 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 operatore ekonomik për mos përmbushje të disa kriterëve të veçanta të kërkuara në DT. Të 3 operatorët e s'kualifikuar kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulëta se fituesi në vlerën që shkojnë nga 45,000,000 milion lekë në **77,310,876lekë**, me TVSH. Sipas, KVO s'kualifikimi i tyre është bërë kryesisht sepse dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është për pune ne ujësjellës dhe në këto kushte, nuk plotëson piken, përvojë e suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë KUZ .Për këto s'kualifikime, dy nga operatorët, "B..& Ç..& G..P..G.. C.." dhe "E..& L..& B.." kanë bërë ankesë pranë AK e cila nuk i ka pranuar këto ankesa. Në vijim të dy operatorët kanë paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 652/2017, ka vendosur, të mos i pranojë këto ankesa. Me këtë vendim të KPP, këta operatorë nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe çështja vazhdojnë të jene në gjykim e sipër.

Meqenëse çështja e s'kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat Administrative, auditimi nuk mundë të dali me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtij s'kualifikimi. Megjithatë me qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa eficencë, efektivitet dhe economicitet apo dhe dëmeve ekonomike që mundë të rrjedhin nga fitimi i gjyqeve nga operatori dalim me konkluzionin se, KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" dhe mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtij operatori ti konsideronte si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe ***kursim të fondeve buxhetore në vlerën 77,310,876lekë me TVSH***që është diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues, me vlerën e ofertës së bashkimit të operatorëve "B..& "C...&G...P...G C.." i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 39-43 të Raportit të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: AKUKM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 77,310,876lekë .
Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

5.2.Në përfundim të proceseve gjyqësore,në rast se,Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të skualifikuar,të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi i gjykatës .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

6.Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit te qytetit te Përmetit" me fond limit:497,705,115 lekë pa TVSH, me fitues operatori Ekonomik "A..." me vlerë oferte 489,207,527 lekë. Në këtë procedurë nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 4 operatore ekonomik. Ndër operatorët e s`kualifikuar 2 operatorë " G..P..G..C.. " dhe "A...& B...& B..-I...&E...& L.."kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se fituesi në vlerën që shkojnë nga rreth20 milion lekë në rreth 110milion lekë. Sipas, KVO skualifikimi i tyre është sepse nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta, te vendosura në DT, kryesisht që ka të bëjë me mos plotësimin përvojës së mëparshme të suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë. Për këtë s`kualifikime, operator"A...& B...& B..-I...&E...& L.." ka bërë ankesë pranë AK e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë. Në vijim ky bashkim operatorësh paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 527/2017, ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik "L...& B..-I...& E.." & B...& A...". Me këtë vendim të KPP, ky bashkim operatorësh, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs për pezullimin e këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe çështja deri në momentin e këtij auditimi vazhdon të jetë në proces gjykimi në gjykatat administrative. Meqenëse çështja e s`kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat administrative, auditimi nuk mundi të dalë me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre s`kualifikimeve. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipërme qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa efencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore, KVO duhet të ishte me tolerante dhe ti referohej pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" që, mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve konsiderohen si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore **në vlerën 98,032,681 lekë** i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së të BO "A...& B...& E...&B...& L..", që është oferta me e ulët ekonomikisht e paraqitur në këtë tender.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 51-54, të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: AKUKM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit në shumën 98,032,681lekë .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

6.2.Në përfundim të proceseve gjyqësore,në rast se,Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të skualifikuar,të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi i gjykatës .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

7.Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Ujësjetllësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Galldishte& Rrjeti i brendshëm i ujësjetllësit Ersekë" me fond limit

363,748,731 lekë pa TVSH , me fitues, operatori ekonomik “A...”me ofertë 358,059,753.5 lekë.

Në këtë procedurë nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar 4 operatore ekonomik, 3 nga këto operatorë të s` kualifikuar: “B..”, “P.V.-K...”dhe B..“L...& B...& “H..” &E..”, kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi që shkojnë nga rreth 10 milion lekë, me TVSH në rreth 72 milion lekë, me TVSH. Sipas, KVO s` kualifikimi i tyre është bërë sepse nuk përmbushin disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT dhe kryesisht sepse nuk plotëson përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, kërkesë kjo e vendosur në DT. Për këtë s` kualifikime, BO “L...& “B..& H...& E..” ka bërë ankesë pranë AK e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë. Në vijim ky bashkim operatorësh paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 815, date 03.12.2018 ka përfunduar procedimin administrativ për këtë procedurë, duke lënë kështu në fuqi vendimin e KVO për s` kualifikimin e këtij operatori. Me këtë vendim të KPP, ky bashkim operatorësh, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs për pezullimin e këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë e cila me vendimin nr.159, datë 20.12.2018, nuk ka pranuar kërkesën e këtij operatori. Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë. Meqenëse çështja e s` kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat administrative, auditimi nuk mundi të dalë me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre s` kualifikimeve. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipërme qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, KVO duhet të ishte me tolerante dhe ti referohej pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” që, mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve konsiderohen si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore **në vlerën 71,984,286 lekë**, i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s` kualifikuar dhe konkretisht, të operatorit “B..”,që është oferta me e ulët ekonomikisht e paraqitur në këtë tender.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-58 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: AKUKM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit në shumën 71,984,286lekë .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

7.2.Në përfundim të proceseve gjyqësore,në rast se,Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të skualifikuar,të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi i gjykatës .

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

8. Gjetje nga auditimi:Nga buxhetit të shtetit në vitet 2015-2019, janë akorduar fonde për realizimin e objektin "Furnizimi me ujë i qytetit të Kukësit dhe të 14 fshatrave përreth ", faza e dytë. Për këtë objekt, në vitin 2015 është realizuar procedura e prokurimit ku është lidhur dhe kontrata me nr. 2101, datë 23.07.2015 me BOE "A.."& "C.."&"B..."& " S.A..." i përfaqësuar nga shoqëria "C.."me vlerë 186,320,122 lekë me TVSH. Më pas AK ka lidhur edhe shtesë kontrate (me procedurë negociim pa shpalle) me vlerë 37,186,771 lekë me TVSH. -Nga ana e AK, për monitorimin e punimeve dhe raportimi i gjendjes aktuale të realizimit të punimeve në objekt, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 64, datë 27.05.2019, është

ngritur grupi i punës. Me memon e datës 11.06.2019, grupi i punës rendit të gjithë historikun e veprës dhe problemet e zbatimit të punimeve të kryera apo të pa kryerja nga Kontraktori dhe mbikëqyrur nga supërvizori i punimeve. Në përfundim grupi i punës konstaton se, punimet në objekt nuk kanë përfunduar dhe në kantier nuk ekziston asnjë punonjës apo makineri. Kanë kaluar 523 ditë kalendarike nga data 31.12.2017 (sipas afateve kontraktuale), e cila ishte data e përfundimit të punimeve (K. bazë + K. shtesë). Kontraktori dhe mbikëqyrësi nuk pranojnë përgatitjen e dokumentacionit teknik të objektit (Librezë masash, procesverbale, azhornime, ditarë, korrespondenca, certifikata materialesh etj.), në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 13.06.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II "Zbatimi i punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar. Mosmarrëveshjet e krijuara midis AK, Kontraktorit dhe Mbikëqyrësit të punimeve, nuk po zgjidhen me negociata të drekte. AK ka humbur besueshmërinë se, Kontraktori dhe Mbikëqyrësi, mund të angazhohen dhe të kenë kohë të përfundojnë objektin brenda kushteve të kontratës. Grupi i punës i rekomandon titullarit se, pasi janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të bërë të mundur realizimin e objektit të përputhje me projektin dhe kontratën, me qëllim minimizimin e dëmeve të mëtejshme, shikohet si të vetmen rrugë që, AK të veprojë sipas nenit 42 "Ndërprerje për Mosplotësim" të kontratës nr. 2101, datë 23.07.2015.

- Në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratës u vërejtën, probleme dhe pengesa të cilat nuk janë për gabime apo faj të kontraktorit. Konkretisht, në fshatin Lomje punimet janë realizuar në prani të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Kukës, sepse janë hasur shumë konflikte midis shoqërisë zbatuese dhe banorëve të fshatit. Për këto konflikte janë bërë 15 Kallëzime penale për personat të cilat pengonin punimet, për të cilët kanë dal edhe Vendime të Gjykatës së shkallës së parë, Kukës. Shkak tjetër për mos ecurinë e punimeve është bërë edhe Agjencia e Zonave të Mbrojtura Kukës e cila ka realizuar pezullime, me arsyetimin se punimet nuk disponojnë leje mjedisore. Për këto veprime Kontraktori ka bërë ankime dhe ka kërkuar zgjidhjen e problemeve, në AKUKM, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Bashkinë Kukës dhe Kryeministrin. Por nga ana e këture institucioneve janë neglizhuar zgjidhjet e këtyre problemeve, dhe për pasojë nga mbikëqyrësi i punimeve është mbajtur procesverbal të posacëm është bërë pezullimi i punimeve deri në plotësimin e disa kërkesave të cilat do të bënin të mundur zbatimin e punimeve. Në vijim, që nga data 27.09.2017 e deri në momentin e auditimit, midis shoqërisë dhe AK, ka disa shkëmbime korrespondencash por nuk është dhënë asnjë zgjidhje për realizimin e objektit, siç janë: shtyrje e afatit të lejes së ndërtimit, leje mjedisore, Akt marrëveshje me banorët e fshatit Lomje, Leje nga ARRSH si dhe detaje në lidhje me zbatimin e projektit. Nga njëra anë ana e AKUKM, më të drejtë ngrihet pretendimi se, të drejtën e aplikimit për pajisje me leje mjedisore dhe lejeve të tjera e ka sipërmarrësi i punimeve dhe AK nuk ka asnjë kompetencë që të detyrojë këto institucione për pajisjen e kontraktorit me këto leje, ndërsa nga ana tjetër nga kontraktori ngrihet pretendimi se, nga data 27.02.2017, AK nuk ka shlyer detyrimet e punimeve të kryera nga sipërmarrësi, të certifikuara nga mbikëqyrësi dhe të miratuara nga Titullari i Institucionit. Mbas shumë korrespondencash ndërmjet palëve, AKUM, ka vënë në dijeni Kontraktorin dhe Agjencinë e Prokurimeve Publike për zgjidhjen e kontratës me nr. 2101, datë 23.07.2015, me objekt: "Furnizimi me ujë i qytetit të Kukësit dhe të 14 fshatrave përreth "faza e II" si dhe shtesës së kontratës me nr 1042, datë 24.04.2017.

Për sa më sipër dalim në konkluzionin se, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve në cilësinë e Investitorit, së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministri e linjës direkte, duhet të bashkëpunonte me: Ministrinë e Brendshme, Bashkinë e Kukësit, Ministrinë e Mjedisit apo me institucionet e tjera shtetërore për shmangien e pengesave dhe barrierave burokratike për të ndihmuar

kontraktorin në marrjen e çdo lloj leje apo licenca, pavarësisht se, kush e kishte apo e ka të drejtën për të aplikuar për marrjen e këtyre lejeve. Sepse, nga njëra anë vonesat në marrjen e lejeve apo mos marrja e këtyre lejeve për shkaqe subjektive nuk mund të behën shkak për zgjedhjen e kontratës dhe mos realizimin e këtij objekti me interes kaq të madh publik. Nga ana tjetër zgjidhja e kontratës në mënyrë të njëanshme i jep mundësinë Kontraktorit të hap proces gjyqësor dhe realizimi i këtij objekti mund të shtyhet për vite me radhë. Për më tepër në raste se, kontraktori fiton gjyqit, përveç vlerës së investimit që deri më tani ka shkuar në shumën 171,978,659 lekë do të kemi rritje fiktive të konsiderueshme të kostos së këtij objekti në dëm të buxhetit të shtetit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 58-71, të Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: AKUKM, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, për analizimin e shkaqeve dhe arsyeve të mosrealizimit të objektit që, deri më tani kosto e investimit e menaxhuar, pa efikasitet, pa efektivitet dhe pa ekonomikitet ka shkuar në shumën **171,978,659 lekë**, dhe në varësi të rezultateve të kësaj analize të gjejnë rrugët e bashkëpunimit me kontraktorin për të ri lidhur kontratën me qëllim vijimin e punimeve për realizimin përfundimtar të këtij objekti. Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

8.2. Rekomandimi: Në raste të hapjes së procesit gjyqësor nga Kontraktori, AKUKM dhe MIE të bashkëpunojnë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e kostove të tepërta në dëm të buxhetit të shtetit që, mundë të vijnë nga vendimi i gjykatës, nëse jepet në favor të Kontraktorit.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

8.3.Rekomandimi: Në përfundim të procesit gjyqësor,në rast se, Vendimi i Gjykatës merr formë të prerë dhe është në favor të sipërmarrësittë punimeve, AKUKM: të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës,për dëmin ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit,për mosvënien në punë të këtij Ujësjiellësi që është me interes kaq të madh social për komunitetin e Rajonit tëKukësit, si dhe të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik që mund të përcaktohet në Vendimin e Gjykatës.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës**

B.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi:Procedura e prokurimit me objekt, “Ndërtimi i Kolektorit kryesortë ujërave të zeza dhe I.T.U.P, në zonën turistike Gjiri i Lalzit, Durrës”, me fond limit: 1.197.059.822 lekë pa TVSH, me fitues shoqërinë e Huaj ”S..” me vlerë oferte 1,179,102,179 lekë. Në këtë procedurë nga 6 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar5 operatore ekonomik, ndër ta ndër2 operatorë “A..” dhe “G..” janë s`kualifikuarme arsyen se, nuk plotëson kriteret e veçanta të kërkuara në DT dhe pikërisht, nuk plotësojnë kriterin për punë të ngjashme. Ndërkohë operatori “G...” “ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se, fituesi në vlerën149,046,666 lekë, pa TVSH. Në lidhje me auditimin mbi ligjshmëritë e arsyeve të s`kulifikimeve të dy operatorëve është e rëndësishme të përmendim dhe të trajtojmë faktin se, një nga këta operatorë, operatori “Gener 2”është në proces gjyqësor për s`kualifikim të

padrejtë nga në një procedurë tjetër prokurimi të zhvilluar po nga ky Autoritet Kontraktor. Konkretisht:

Një muaj para hapjes së kësaj procedure, në datën, data 25.08.2016, ky Autoritet Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II (pika B.1.4 e mësipërme). Në këtë procedurë ka marrë pjesë edhe operatori ekonomik "G...." i cili për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme ka paraqitur të njëjtin dokumentacion si në procedurë që po trajtojmë, "Ndërtimi i Kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P, në zonën turistike Gjiri i Lalzit, Durrës"). KVO e ka s'kualifikuar, operatori ekonomik "G...." nga procedura e prokurimit "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II", pikërisht për të njëjtat arsye si në rastin e s'kualifikimit nga procedurë, "Ndërtimi i Kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P, në zonën turistike Gjiri i Lalzit, Durrës".

Për s'kualifikimin nga procedura "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II", operatori "G...." ka paraqet ankesë pranë AK i cili nuk e ka pranuar ankesën dhe më paska paraqitur ankesë edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili edhe kynuk e ka pranuar ankesën e paraqitur dhe më paska bërë rekurs në Gjykatat Administrative dhe deri në momentin e auditimit çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit.

Meqenëse çështja e s'kualifikimit të tij vazhdon të jetë në shqyrtim nga gjykata administrative e Apelit, auditimi nuk mundë të dali me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre s'kualifikimeve sepse siç u trajtua, fjala është për të njëjta arsye dhe për të njëjta dokumentacione që gjykata vazhdon ti këtë në proces shqyrtimi dhe gjykimi. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipër me qëllim shmangien e tej zgjatjeve të procedurave të prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe kostove buxhetore apo përdorimin pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet, dalim në konkluzionin se, KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" për të vlerësuar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të operatorit "G...." dhe të operatorit "A...." si devijime të vogla. Kështu, do të kishim ***edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën 178,856,000 lekë me TVSH*** i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s'kualifikuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 32-38 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve ***në shumën 178,856,000 lekë, pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.***

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

2. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, Rikonstruksion i Ujësjetës të Lagjes "28 Nëntori dhe "Skënderbeu" në qytetin e Elbasanit" me fond limit 400,828,000 lekë pa TVSH, me fitues operatorin Ekonomik "C...." me oferte ekonomike 395,437,204 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 operatore ekonomik, për mos përmbushje të disa kriterëve të veçanta të kërkuara në DT. Një nga operatorët e s'kualifikuar BOE "G...K....&S...I...& E....", ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 21,518,890 lekë, pa TVSH. KVO e ka s'kualifikuar këtë bashkim operatorësh kryesisht se, dy nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh nuk plotësojnë kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DT që ka të bëjë me vlerën e kontratave të ngjashme të realizuar në tre vitet e fundit. Përveç kësaj është s'kualifikuar dhe pse anëtari tjetër operatori "E...." ka

marrë përsipër të kryhej punime ne masën e 1.44%, por sipas ekstraktit historik të QKB është shoqëri vetëm për Mbikëqyrje, Kolaudim dhe Vlerësim Pasurive te Paluajtshme, pra nuk është shoqëri për zbatim punimesh. Megjithatë, KVO duhet të ishte referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” për të vlerësuar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve si, devijime të vogla.Kështu, do të kishim edhe **kursim të fondeve buxhetore në vlerën 25,822,668 lekë** me TVSH, i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së këtij bashkimit të operatorët të s’kualifikuar “**G.. K... & S.. I.&E...**”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 43-46, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve **në shumën 25,822,668 lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet.**

Afati për zbatimin e rekomandimit:**Menjëherë**

3.Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Impianti i Trajtimit te Ujërave te Ndotura ne zonën Bregdetare Dhrale -Palase, Loti I parë" me fond limit 129,512,139 pa TVSH, me fitues operatorin ekonomik “**G...**” me vlerë oferte 115.254,993 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 3 operatore ekonomik: “**G...**”, “**Sh...-I..**”dhe “**B..Shpk**” & “**K..**”. Dy nga nga këta operatorë, “**Sh..-I..**”dhe “**B..Shpk**” & “**K..**” kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesinë vlerën, që shkojnë nga rreth 4.3 milion lekë në rreth 13 milion lekë.Sipas KVO s’kualifikimi i të tre është bërë për mos përmbushje të disakritereve të veçanta të kërkuara në DT. Për këto s’kualifikime, të treoperatorëtkanë bërë ankesë pranë AKe cila nuk i ka pranuar këto ankesa. Në vijim të treoperatorëtkanë paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. nr.576, datë 26.07.2017, ka vendosur, të mos i pranojë ankesat e dy operatorëve **Sh..-I..**” dhe opertaorit“**B..Shpk**” & “**K..**” dhe për operatorin “**G..**” të pranoje ankesën, anulimin e vendimit të KVO për s’kualifikimin e tij dhe AK të rregulloje shkeljet duke e kualifikuar këtë operator. Mbas vendimit të KPP,KVO ka bërë ri klasifikimin dhe ka nxjerrë fitues operatorin “**G...**” me të cilin është lidhur edhe kontrata e zbatimit me vlerë138,305,992.26 lekë. Edhe pse KPP nuk ka pranuar ankesat e dy operatorëve të tjerë ,KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar *pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006* “Për prokurimin Publik” për të vlerësuar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve devijime të vogla.Kështu, do të kishim edhe **kursim të fondeve buxhetore në vlerën 13,201,780 lekë me TVSH** i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues “**G...**” dhe vlerës së ofertës së operatorit të s’kualifikuar operatori “**B-93**”, që ka paraqitur ofertën më të vogël.

-Po kështu KVO nuk ka bërë korrigjimet matematikore te ofertës së operatorit “**G...**” të shpallur fitues me VKPP, para se të bënte shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit teknik siç përcaktojnë DST. Nga llogaritjet matematikore të zërave të preventivit ofertues së këtij operatori rezultoi se kishte gabime matematikore të cilat ishin mbi2% të vlerës totale të kësaj oferte.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 46-51, të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve **në shumën në vlerën 13,201,780lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet**

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

4. Gjetje nga auditimi: Përobjektin "Ndërtimi i rrjetit të Ujësjetës të Gjirit Lalzit, Durrës" është lidhur kontrata sipërmarrjes me nr. 1663 datë 16.06.2016, me vlerë 249,699,966 lekë pa TVSH. Gjatë zbatimit të punimeve është lidhur dhe realizuar dhe shtesë kontrate me nr. 2806, datë 01.10.2018 me sipërmarrësin e punimeve "D.. C.." & "A..", me vlerë 58,883,444 lekë me TVSH. Siç tregohet, nga shtesa e kontratës se, projekti fillestar i hartuar nga shoqëria "E.." për furnizimin me ujë të pijshëm të njësisë administrative Ishëm, është e pamjaftueshme dhe paraqet rezerva në lidhje me cilësinë. Ky projekt është i pastudiuar mirë dhe nuk është llogaritur në detaje për të gjithë furnizimin me ujë, duke sjellë përdorime pa ekonomikitet, pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike. Nga shqyrtimi dhe studimi i projektit-preventiv të zbatimit dhe specifikimeve teknike, konstatohen edhe përdorime të tjera jo me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike në vlerën 4,944,638 lekë me TVSH. Kjo vlerë përfaqëson vlerën e disa zërave të vendosura në preventivin e zbatimit nga mbikëqyrësi i punimeve në projektin e rishikuar, të cilat teknikisht janë të pa nevojshëm sepse nuk ndikojnë për funksionimin e objektit, duke bërë kështu përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të këtyre fondeve. Po kështu u konstatuan pasaktësi në llogaritjen e volumeve. Situacioni përfundimtar i shtesës pasqyron volumnin 4,410.45 m³ gjermim. Librezat e masave paraqet në mënyrë analitike sipërfaqet e seksioneve të gjermimit të piketave në thellësinë H=1.5 m dhe volumnet e gjermimit të rrugës së re (sipas seksioneve tërthore nga Km 0+033.32 deri 0+650 nga km 3+650 deri në 3+750). Nga verifikimi i librezës së masave (K. bazë + K. shtesë) rezulton se është mbivendosur 2 herë disa seksione të gjermimeve, ku totali i volumnit të mbivendosur është 1,677.05 m³. Për rrjedhojë ky zë punimesh në vlerën 394,442 lekë është i pa rakorduar dhe justifikuar me dokumentacion teknik nga sipërmarrësi i punimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me rregullat e kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

(Trajtuar më hollësisht në faqet 71-74 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve ***në shumën në vlerën 5,339,080 lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet.***

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të Kontratës nr. 1688, datë 10.06.2015 me objekt "Furnizimi me ujë i fshatrave të Komunës Golem", lidhur midis AK dhe sipërmarrësit të punimeve "G..." & "G...", me vlerë 420,309,287 lekë me TVSH, dhe shtesës së kontratës me nr. 1535, datë 02.06.2017 me vlerë 76,473,157 lekë u konstatua se:

-Ky projekt gjatë zbatimit të punimeve ka paraqitur pamjaftueshmëri dhe rezerva në lidhje me cilësinë pasi, nuk është i studiuar mjaftueshëm dhe nuk është llogaritur në detaje për të gjithë elementët e objektit për funksionimin normal të tij (furnizimin me ujë).

-Për llogaritjen e vlerës së preventivit shtesës të punimeve nga mbikëqyrësi i punimeve, në të cilin përfshihen dhe analiza të reja çmimesh, nuk është marrë miratim nga projektuesi i veprës, ndërkohë, mbikëqyrësi i punimeve, ka kërkuar dhe lidhur shtesë kontrate për shërbimin e mbikëqyrjes të punimeve shtesë.

-Nuk ekzistojnë korrespondenca me përfituesit e Ujësjetës Kanalizime Kavajë SH.A, nuk disponohen opinionet e sugjerimeve të ndryshme nga përfituesit dhe AK, mbi shtesën e projektit-preventiv, si dhe nuk ekzistojnë miratime të ndryshmeve nga projektuesi të projektit-preventiv shtesë në masën 18.7 %.

Veprimet e mësipërme, kanë sjellë përdorime pa ekonomikitet, pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike në vlerën 78,614,844 leke me TVSH dhe janë në kundërshtim me kreu III, neni 5 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", pikën 3.1, të VKM, nr. 1, datë 16.06.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e

punimeve të ndërtimit" dhe me pikën 8 të VKM, nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 74-81, të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve *në shumën në vlerën 78,614,844lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet.*

5.2. Rekomandimi: AKUKM, në bashkëpunim me projektuesin dhe me mbikëqyrësin e punimeve, të analizojnë dhe të argumentojnë me dokumentacion justifikuese tekniko-ligjor domosdoshmërinë e zërave të punimeve që nuk kanë qenë të përfshira në projektin dhe preventivin fillestar të miratuar nga Drejtoria Teknike, por janë përfshirë dhe kryergjatë zbatimit apo në përfundim të punimeve, sipas shtesës së kontratës.

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë masat që do të marrë AKUKM për zbatimin e këtij rekomandimi, duke e vlerësuaratë nëvarësitë argumenteve dhe të dokumentacionit tekniko-ligjor shoqëruar që do të paraqitet brenda 20 ditëve, në zbatim të nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe në auditim radhës që KLSH do të kryejë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

6. Gjetje nga auditimi: Për ndërtimin e objektit "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga pus shpimet e Çermës, Loti II: Linja e ujës-jellës me presion nga ura e Rrogozhinës piketa 426 deri në pus - ndërprerje Kavajë, pus - ndërprerje Kavajë, linja e Ujës-jellës pus - ndërprerje deri në depon ekzistuese Kavajë;(Shtesë kontrate)", është lidhur në datën 03.04.2015 kontrata e zbatimit me nr. 1060, me sipërmarrësin e punimeve "A...", me vlerë 933,433,147 leke (me TVSH). Më pas gjatë zbatimit të punimeve është lidhur edhe një kontratë shtesë me date 14.04.2017 me nr. 939 me vlerë 178,887,274 lekë (me TVSH). Projekti dhe preventivi i zbatimit të këtij objekti është hartuar nga shoqëria projektuese "HUKProjekt". U konstatua se:

-Ky projekt gjatë zbatimit të punimeve ka paraqitur pamjaftueshmëri dhe rezerva në lidhje me cilësinë pasi, nuk është i studiuar mjaftueshëm dhe nuk është llogaritur në detaje për të gjithë elementët e objektit për funksionimin normal të tij (furnizimin me ujë).

-Për llogaritjen e vlerës së preventivit shtesës të punimeve nga mbikëqyrësi i punimeve, në të cilin përfshihen dhe analiza të reja çmimesh, nuk është marrë miratim nga projektuesi i veprës, ndërkohë, mbikëqyrësi i punimeve, ka kërkuar dhe lidhur shtesë kontrate për shërbimin e mbikëqyrjes të punimeve shtesë.

Në rastin e mësipërm nuk ekzistojnë korrespondenca me përfituesit e Ujës-jellës Kanalizime Durrës-Kavajë SH.A, nuk disponohen opinionet e sugjerimeve të ndryshme nga përfituesit dhe AK, mbi shtesën e projektit-preventivit, si dhe nuk ekzistojnë miratime të ndryshmeve nga projektuesi të projektit-preventivit shtesë në masën 19.2 %,

Veprimet e mësipërme, kanë sjellë përdorime pa ekonomikitet, pa efektivitet dhe pa efikasitet të fondeve publike në vlerën 189,281,872 lekë me TVSH, dhe janë në kundërshtim me kreu III, nenin 5 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", pikën 3.1, të VKM, nr. 1, datë 16.06.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" dhe me pikën 8 të VKM, nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të

Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-83, të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve *në shumën në vlerën 189,281,872 lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet*

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

6.2. Rekomandimi: AKUKM, në bashkëpunim me projektuesin dhe me mbikëqyrësin e punimeve, të analizojnë dhe të argumentojnë me dokumentacion justifikuese tekniko-ligjor domosdoshmërinë e zërave të punimeve që nuk kanë qenë të përfshira në projektin dhe preventivin fillestar të miratuar nga Drejtoria Teknike, por janë përfshirë dhe kryer gjatë zbatimit apo në përfundim të punimeve, sipas shtesës së kontratës.

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë masat që do të marrë AKUKM për zbatimin e këtij rekomandimi, duke e vlerësuar atë në varësi të argumenteve dhe të dokumentacionit tekniko-ligjor shoqëruar që do të paraqitet brenda 20 ditëve, në zbatim të nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe në auditimin e radhës që KLSH do të kryej për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

7. Gjetje nga auditimi: Për ndërtimin e objektit *Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së plazhit, Lagja 13, Durrës*; (Shtesë kontrate)", është lidhur në datën 23.12.2015 kontrata e zbatimit me nr 3803 me sipërmarrësin e punimeve JV "C..." & "X..." me vlerë 151,528,942 leke (me TVSH). Më pas gjatë zbatimit të punimeve është lidhur edhe një kontratë shtesë me date 25.04.2017 me nr. 1035, me vlerë 30.224.009 lekë (me TVSH). Projekti dhe preventivi i zbatimit të këtij objekti është hartuar nga shoqëria projektuese "I...". U konstatua se:

-Ky projekt gjatë zbatimit të punimeve ka paraqitur pamjaftueshmëri dhe rezerva në lidhje me cilësinë pasi, nuk është i studiuar mjaftueshëm dhe nuk është llogaritur në detaje për të gjithë elementët e objektit për funksionimin normal të tij (furnizimin me ujë).

-Për llogaritjen e vlerës së preventivit shtesës të punimeve nga mbikëqyrësi i punimeve, në të cilin përfshihen dhe analiza të reja çmimesh, nuk është marrë miratim nga projektuesi i veprës, ndërkoh, mbikëqyrësi i punimeve, ka kërkuar dhe lidhur shtesë kontrate për shërbimin e mbikëqyrjes të punimeve shtesë.

Në rastin e mësipërm nuk ekzistojnë korrespondenca me përfituesit e Ujësjetës Kanalizime Durrës-Kavajë SH.A, nuk disponohen *oponenca sugjerime të ndryshme nga përfituesit dhe AK*, mbi shtesën e projektit-preventivit, si dhe nuk ekzistojnë miratime të ndryshimeve nga projektuesi të projektit-preventivit shtesë në masën 19.2 %,

Veprimet e mësipërme, kanë sjellë përdorime pa ekonomikitet, pa efektivitet dhe pa eficensë të fondeve publike në vlerën 30,305,479 lekë me TVSH dhe janë në kundërshtim me kreu III, neni 5 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", pikën 3.1, të VKM, nr. 1, datë 16.06.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" dhe me pikën 8 të VKM, nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 83-84 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: AKUKM, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve *në shumën në vlerën 30,305,479 lekë, pa efektivitet dhe ekonomikitet*

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

7.2Rekomandimi: AKUKM, në bashkëpunim me projektuesin dhe me mbikëqyrësin e punimeve, të analizojnë dhe të argumentojnë me dokumentacion justifikuese tekniko-ligjor domosdoshmërinë e zërave të punimeve që nuk kanë qenë të përfshira në projektin dhe preventivin fillestar të miratuar nga Drejtoria Teknike, por janë përfshirë dhe kryer gjatë zbatimit apo në përfundim të punimeve, sipas shtesës së kontratës.

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë masat që do të marrë AKUKM për zbatimin e këtij rekomandimi, duke e vlerësuar atë në varësi të argumenteve dhe të dokumentacionit tekniko-ligjor shoqërues që do të paraqitet brenda 20 ditëve, në zbatim të nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në auditimin e radhës që KLSH do të kryhej për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

B.3. MASA PËR PARANDALIMIN E DËMIT EKONOMIK:

1 Gjetje nga auditimi: Projekti “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”. Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze (JICA, JapaneseInternationalcooperationagency) dhe ratifikuar në Kuvend përmes ligjit nr. 9964, datë 24.7.2008.

Mbas përfundimit të procedurave të prokurimit të finalizuar në vitin 2013, në datën 30.01.2014, është nënshkruar kontrata për zbatimin e punimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (DPUK), sot AKUKM dheshoqërisë së përbashkët BO **D.I.& K.**, Japoni. Kontrata e sipërmarrjes është me vlerën rreth 81,000,000 Euro dhe është nënshkruar në datën30.01. 2014 dhe punimet kanë filluar në datën 16.06.2014 me afat 30 muaj. Më pas afati i punimeve është shtyrë deri në 30.10.2018. Projektues dhe Supervisor është bashkimi i shoqërisë **T.**, Japoni &Europartners, Shqipëri. Zbatimi i kësaj kontrate (projekti) është i organizuar duke u ndarë në dy seksione: ndërtimi i Impiantit të përpunimit të Ujërave të Zeza dhe ndërtimi i linjës qendrore të Kanalizimeve me teknologjinë e Mikrotunelit. Kjo kontratë është ndërprerë në datën 04.07.2018 dhe deri në këtë datë, punimet ishin kryer rreth 70% ose në vlerën 56 Milion Euro.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e ndërprerjes së kontratës, u konstatua:

Me shkresën nr. 2004, datë 04.07.2018 AKUKM, ka njoftuar Kontraktorin për ndërprerjen e kësaj kontrate. Këtë Urdhër AKUKM e ka marrë në zbatim të shkresës 1225/11 datë 31/05/2019të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e cila ka urdhëruar, këtë AKUKM që brenda muajit qershor 2018, të fillojnë procedurat për ndërprerjen e kontratës me Kontraktorin.Urdhërimi i ndërprerjes së kësaj kontrate është në vijim të zbatimit të masave organizative, të lëna nga struktura e auditimi i brendshëm të kësaj ministrie si rezultat e i një auditimi të kryer gjatë periudhës 03.11.2017 deri 30.01.2018 për këtë projekt.Sipas shkresës njoftuese të ndërprerjes së kontratës shkak është bërë Kontraktori sepse ka shkelur disa kushte të kontratës, konkretisht, pikën e kontratës 15.2, gërmat a; b; c; d.

Mirëpo, nga ana procedurale ky akt është kryer në kundërshtim të hapur me marrëveshjen e borxhit të ratifikuar me ligjin nr. 9964 datë 24.7.2008, sepse në kapitullin “Programi 4”, “Seksioni 4”,Pika 5 të kësaj marrëveshje, përcaktohet qartësisht se:”Çdo modifikim ose anulim i një kontrate të rishikuar nga Banka kërkon miratimin paraprak me shkrim të Bankës për këtë, megjithatë, me kusht që çdo ndryshim që nuk përbën një modifikim të rëndësishëm

të kontratës dhe që nuk cenon çmimin e kontratës nuk do të kërkojë një miratim të tillë nga Banka”.

Në zbatim të kësaj pike, MIE dhe AKUKM nuk ka njoftuar paraprakisht Bankën Japoneze për Zhvillim, “JICA”, për të marrë miratim e saj për këtë ndërprerje të kontratës. Anulimi apo pezullimi i kontratës është ndryshim shumë i rëndësishëm, që MIE dhe AKUKM para se, të merrte një vendim për ndërprerjen, detyrimisht duhet të njoftonte Bankën dhe të merrte miratimin e saj për këtë ndërprerje. Por, Banka është njoftuar zyrtarisht nga AKUKM në datën 10.09.2018 dhe miratimi i saj u kërkuar vetëm pasi kontrata kishte mbi 2 muaj që ishte ndërprerë. Pra shkresa nr.2004, datë 04.07.2018 për ndërprerjen e kontratës nuk ka asnjë vlerë juridike para faktit të kryer në kushtet kur Kontraktori në datën 19.07.2018 u detyrua të dilte nga kantieri dhe të dorëzonte kantierin dhe punën e kryer deri në atë moment. Ndodhur para këtij fakti të kryer, nga njëra anë marrja e vendimit nga Banka Japoneze për Zhvillim, “JICA” për mos miratimin e ndërprerjes së kontratës nuk do kishte asnjë vlerë juridike pasi, Kontraktori tashmë ishte larguar në mënyrë arbitrare nga kantieri dhe nga ana tjetër, mund të prodhonte konsekuenca deri në prishjen e marrëveshjes financiare dhe ndodhur në këto kushte, Banka Japoneze për Zhvillim, “JICA” me shkresën nr. 10-15001, datë 15.10.2018 ka dhënë pas faktit, miratimin e ndërprerjes së kontratës.

Përveç kësaj, nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve në bazë të cilave është justifikuar ndërprerja e kësaj kontrate u konstatua se, Kontraktori i ka plotësuar të gjitha kushtet kontratuale, ndryshe nga ç ‘pretendohet në shkresën e AKUKM nr. 2004, datë 04,07.2018. Shkurtimisht po përmendim me kryesoret:

Ka bërë sigurimin e kontratës pranë shoqërisë “A..” sh.a. me policën me nr 46453930 në datën 11.07. 2017 me vlerë rreth 8 milion Euro; nuk ka shfaqur probleme në ngritjen e kantierit, nuk ka shfaqur probleme në respektimin e kushteve teknike, nuk ka shfaqur probleme në cilësinë e punimeve, nuk ka kontraktuar punimet me një nënkontraktor por me disa nënkontraktor, në respektim të plotë me standartin e kontratave FIDIC. Për të gjithë këtë performacë të Kontraktorit, MIE dhe AKUKM ka pasur dijeni të plotë, të vërtetuara këto me një mori shkresash si, situacionet, mbledhesh në kantier, raportet periodike, etj.

Për të nxjerrë më në dukje se, akti për ndërprerjen e kontratës dhe arsyet e justifikimit të ndërprerjes ***nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe marrëveshjen e financimit, po i referohemi pikës 20.2 të kontratës.*** Kjo pikë përcakton ngritjen e Këshillit të Mosmarrëveshjeve (DisputeBoard). Ky këshill është një komision i organizuar sipas rregullave të arbitrazhit ndërkombëtar dhe përbehet nga tre anëtarë, ku një anëtar zgjidhet nga Punëdhënësi një nga Kontraktori dhe i treti me marrëveshje të dy palëve. Këshilli i Mosmarrëveshjeve kryen mbledhje periodike çdo tremujor ku palët shprehin rezervat dhe shqetësimet në lidhje me mbarëvajtjen e projektit. Ky organ ka funksionuar nga fillimi i zbatimit të punimeve dhe ka mbajtur raportin tij të parë më datë 25.02.2015 dhe raportin e fundit në datë 12.05.2018. Nga auditimi që ju bë këtyre raporteve u konstatuan se, kanë dalë disa probleme (mosmarrëveshje) ndërmjet Punëdhënësit, Kontraktorit dhe Supervisorit, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, në:

-Mungesa të hapësirave për të kryer punimet; mungesa apo vonesa të tej zgjatuara të pagesave në vlera bllokuesve ndaj Kontraktorit si, vonesa në likuidim, si të TVSH ashtu dhe të shërbimeve apo punimeve të realizuara nga kjo kontratë (pagesa të situacioneve). Për mos pagesat në kohë, punëdhënësi është munduar të justifikohet gjithmonë, duke premtuar që pagesat do behën sa më shpejtë, por situata ka ngelur e pa ndryshuar, gati për një periudhë tre vjeçare;

- Mos marrje apo vonesa të miratimeve të leje të ndryshme (mungesë të theksuar bashkëpunimi në lidhje me marrjet e lejeve, miratimet e punimeve. etj.).

-Probleme të hasura gjatë zbatimit me projektin dhe mungesa e gatishmërisë për korrigjimin apo përmirësimin e tij ,etj.

Sa sipër del qartë se, ndërprerja (zgjidhja) e kësaj kontratës në mënyrën të njëanshme, pa marrë miratim paraprak nga financuesi Banka Japoneze për Zhvillim, “JICA” dhepa marrë parasysh sugjerimet dhe vërejtjet e këshillit të mosmarrëveshjeve është në kundërshtim me nenin 15.2 të kontratës së lidhur me Kontraktorin JV “**D..& K..**”.

Ndodhur në këtë situatë, në zbatim të pikës 20.6 të kontratës, shoqëria kontraktuese BO “**D..& K..**”, ka depozituar kërkesën për arbitrazh pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Londër. Kjo gjykatë me njoftimin zyrtar të datës 19.12.2018 ka njoftuar zyrtarisht palët, MIE dhe Kontraktorin për hapjen e kësaj çështje.

Si përfundim, gjendja aktuale e ecurisë së zbatimit të projektit paraqitet:

Kantieri i Kontraktorit është totalisht i braktisur (jo i demontuar). Punimet janë lënë në mes. Nga nxitimi për të nxjerrë Kontraktorin nga kantieri nuk janë kryer punimet konservuese si, izolimi i betoneve dhe i hekurit, mbyllja dhe taposja e pusetave, sistemimi i zonave me rrezikshmëri rrëshqitjeje, mbyllja e puseve të Mikrotunelit, etj. Strukturat janë në mëshirë të kushteve atmosferike, ujit, baltës, diellit dhe bimësisë. Për më tepër gjatë kësaj periudhe nuk u kryen dhe shërbimet mirëmbajtëse si pastrimi i kanaleve mirëmbajtja e rrjetit të drenazhimit, ndezja e pompave për rruajtjen e punimeve të rrjetit të kanalizimeve të kryera, etj. Po ashtu dhe punimet e mikrotunelit duke qenë të pa lidhura ekziston mundësia që pusetat të lëvizin duke humbur kuotën dhe të dalin jashtë përdorimit.

Rreziku i kësaj shtate, duke qenë se punimet konservuese nuk janë kryer dhe po të kemi parasysh që lidhja e një kontrate tjetër ndërkombëtare do të kërkonte nga fillimi i procedurave 2 vjet (procedurat ende nuk kanë nisur), ekziston mundësia që punimet e kryera deri më tani të amortizohen plotësisht.

Siç u tha më sipër, për prishjen e kësaj kontrate, Kontraktori ka hapur çështje në gjykatën pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Londër dhe për çka u trajtua më lartë ka shumë gjasa që këtë çështje ta fitojë dhe në rast se e fiton, buxheti i shtetit do të paguaj një shumë tepër të madhe që mundë të shkojë **mbi 90 milion Euro**, e analizuar si më poshtë:

-Nga humbja e punimeve të kryera dhe pagesave ndaj Kontraktorit rreth **55,000,000 Euro**;

-Nga humbja e pagesave të konsulentit (supervizorit) i cili në zbatim të standardit të kontratave FIDC vazhdon ende të paguhet dhe do të vazhdoje të paguhet deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Deri tani kosto e këtij konsulenti të paktën ka arritur **mbi 10,000,000 Euro**;

-Nga humbja e arbitrazhit duke qenë se ndërprerja e kontratës në kushtet kur Autoriteti Kontraktor nuk i ka vënë në dispozicion sheshet dhe nuk e ka paguar sipas kontratës nuk është favorizuese rreth **20,000,000 Euro** (kërkesa fillestare e Kontraktorit ne arbitrazh);

-Nga shpenzimet të tjera administrative, si, shpenzime shtesë si pasoje e degradimit të punimeve të kryera, shpenzime për sigurinë e objektit, shpenzime për pagesat e avokateve, shpenzime gjyqësore, etj;

-Nga interesat e kredisë sepse financimi i kësaj kontrate është bërë nga kredia e Qeverisë Japoneze, pra do paguhet interesa për një investim që nuk është kryer.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 87-95, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Me qëllim, shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të shtetit i llogaritur afërsisht rreth **90 milion Euro**, në rast të humbjes së gjyqit në gjykatën e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Londër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të bëjë të pa mundurën që të gjejë gjuhën e bashkëpunimit me Kontraktorin BO “**D..,I..& K.., Japoni**”, *për ti kërkuar tërheqjen e tij nga çështje që ka hapur në këtë gjykatë, dhe njëkohësisht në këmbim, ti kërkojë Kontraktorit të rilidhë kontratën për vazhdimin e zbatimit të punimeve.*

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë1.2.** Me qëllim vazhdimin e financimit të këtij projekti kaq të madh dhe të rëndësishëm në dobi të komunitetit, por dhe të financave publike, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ti kërkojnë, Këshillit të Ministrave që të fillojë menjëherë negociatat me Qeverinë Japoneze **për miratimin e shtyrjes së afatit të marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze, të ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008.**

Menjëherë

D.MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE

Drejtori i Përgjithshëm i “Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë AKUKM për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, reflektimin e tyre dhe përmirësimin e punës dhe proceseve në fushën e infrastrukturës së ujësjetllës kanalizimeve. Në veçanti do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë AKUKM për zbatimin e rekomandimeve, të lëna në pikën B.1, nga rekomandimi 8.1, deri të rekomandimi 8.3. dhe në pikën B.2, nga rekomandimi 5.1 deri te rekomandimi 7.3.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programet me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërbllimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

Raporti Përfundimtar i Auditimit sëbashku me rekomandimet përkatëse i përcillet, Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Kryeministrit të Shqipërisë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ